



## Periodiku AMF

**Zhvillohet konferenca rajonale mbi liberalizimin e tregut të industrisë së sigurimeve, në kontekstin e politikave dhe legjislacionit të BE-së**

Fakulteti i Sigurimeve pranë Universitetit të Shkencave Organizative “Pjetër Budi” në Prishtinë, më datë 4 maj 2009, zhvilloi konferencën rajonale mbi liberalizimin e tregut të sigurimeve, në kontekstin e politikave dhe legjislacionit të BE-së.

*Vijon në faqen 2*

### Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

**Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - prill 2009**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - prill, arritën shifrën 2,658,661 mijë lekë, përkundrejt 2,054,347 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 29.42% më shumë.

*Vijon në faqen 2*

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera

**Zhvillohet seminari mbi investimet dhe pagesat e sistemit të fondeve të pensione**

Federata Ndërkombëtare e Administruesve të Fondeve të Pensioneve, FIAP dhe Dhoma e Pensioneve Polake, IGTE, zhvilluan gjatë periudhës 28 - 29 maj 2009, në Varshavë, Poloni, seminarin ndërkombëtar mbi investimet dhe pagesat e sistemit të fondeve të pensione.

*Vijon në faqen 5*

**Zhvillohet seminari mbi ruajtjen e të dhënave për bashkëpunimin me organet policore dhe gjyqësore në çështjet kriminale**

Njësitë i Ndërtimit të Institucioneve të Bashkimit Evropian (TAIEX) në bashkëpunim me Akademinë e Ligjit Evropian (ERA), zhvilluan në datat 7 dhe 8 Maj 2008, në ambientet e Hotel “Tirana Internacional”

seminarin mbi ruajtjen e të dhënave për bashkëpunimin me organet policore dhe gjyqësore në çështjet kriminale.

*Vijon në faqen 6*

**Zhvillohet seminari mbi menaxhimin në fushën e burimeve njerëzore**

Gjatë periudhës 11 - 15 maj 2009, në Toronto, Kanada, Ministria e Bizneseve të Vogla dhe Shërbimeve Konsumatore, zhvilloi seminarin mbi menaxhimin e burimeve njerëzore.

*Vijon në faqen 6*

**Zhvillohet trajnimi mbi zhvillimin e raporteve për projektin e sistemit të menaxhimit të informacionit (M.I.S)**

Firma zhvilluese Vizor, zhvilloi gjatë periudhës 25 – 29 maj 2009, në Dublin, Irlandë, trajnimin mbi zhvillimin e raporteve për projektin e sistemit të menaxhimit të informacionit (M.I.S).

*Vijon në faqen 7*

**Zhvillohet forumi ndërkombëtar për sigurimet**

Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve në USA (NAIC) me mbështetjen e IAIS, zhvilloi gjatë periudhës 18 - 19 maj 2009, në Washington, USA, forumin ndërkombëtar për sigurimet.

*Vijon në faqen 10*

### Edukimi i konsumatorit

**Material për diskutim mbajtur nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (DP e BSNK) mbi sigurimet, perspektivë e forumit të CFO (Drejtor i Përgjithshëm i Financave)**

( Pjesë e shkëputur nga: The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice, Vëllimi 33, nr.1, janar 2009)

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka publikuar një material për diskutim (DP) mbi kontabilizimin e kontratave të sigurimit dhe risigurimit.

*Vijon në faqen 11*

## Në këtë numër:

Zhvillohet konferenca rajonale mbi liberalizimin e tregut të industrisë së sigurimeve, në kontekstin e politikave dhe legjislacionit të BE-së ..... **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura ..... **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera ..... **8**

Edukimi i konsumatorit ..... **11**

## Zhvillohet konferenca rajonale mbi liberalizimin e tregut të industrisë së sigurimeve, në kontekstin e politikave dhe legjislacionit të BE-së

Fakulteti i Sigurimeve pranë Universitetit të Shkencave Organizative “Pjetër Budi” në Prishtinë, më datë 4 maj 2009, zhvilloi konferencën rajonale mbi liberalizimin e tregut të sigurimeve, në kontekstin e politikave dhe legjislacionit të BE-së.

Fjalën e hapjes e mbajti Prof. Dr. Sofronia Miladinovski, Rektor i Universitetit “Pjetër Budi”, ku midis të tjerave theksoi rëndësinë e kësaj konference.

Gjatë zhvillimit të kësaj konference, u vu theksi në:

- o Kornizën ekzistuese ligjore, në bazë të së cilës funksionon industria e sigurimeve në Kosovë, e cila është e përafërt me direktivat e Bashkimit Evropian, megjithatë hap përpara është hartimi i projektligjit të ri mbi sigurimin e detyrueshëm, i cili është duke u hartuar me ndihmën e Bankës Botërore.
- o Vitin 2010, si periudha kur mund të kalohet në një fazë tjetër të liberalizimit të tregut të sigurimeve në Kosovë.
- o Liberalizimin e tepruar të tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm, që në kushtet e Ballkanit është i vështirë dhe I parakohshëm.

Zj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike pranë AMF-së, prezantoi në punimin me temë: “Sigurimi i detyrueshëm në Shqipëri dhe përfaqja me legjislacionin e Bashkimit Evropian” domosdoshmërinë e hartimit dhe të rejat që sjell ligji i ri i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Zbatimi i

tij sjell uljen e numrit të të pasiguarve, sigurimin e të gjithë avionëve dhe anijeve, përmirësim në sjelljen me dëmet nga shoqëritë, rritjen e efektivitetit dhe bashkëpunimit të të gjithë strukturave, mbrojtje më të mirë të interesave të konsumatorëve, etj. Të gjitha këto janë në funksion të mbrojtjes së interesave të publikut, zhvillimit të tregut të sigurimeve dhe përfaqjes me direktivat Evropiane, në kuadër të angazhimit të Shqipërisë me marrëveshjen e MSA-së.

Materiali i plotë, iu vu në dispozicion anëtarëve të Konferencës, të cilët vlerësuan pozitivisht punën e Institucionit tonë.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar - prill 2009



Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - prill, arritën shifrën 2,658,661 mijë lekë, përkundrejt 2,054,347 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 29.42% më shumë.

Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 46% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 54% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 32.45% të sigurimeve të Jetës dhe 29.17% të sigurimeve të Jo - Jetës.

Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 92.18% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo - Jetës.

Gjatë 4 - mujorit të parë të 2009 u nënshkruan rreth 230,621 kontrata sigurimi, ose rreth 28.94% më shumë se në njëjtën periudhë të vitit 2008.


Grafik: Struktura e tregut të sigurimeve, janar - prill 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - prill (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2008	2009
<b>Periudha janar - prill</b>		
A) Sigurim i Jetës	156,956	207,893
B) Sigurim i Jo - Jetës	1,897,391	2,450,768
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	1,280,788	1,435,659
b) Sigurimi Vullnetar	616,603	1,015,109
<b>TOTAL</b>	<b>2,054,347</b>	<b>2,658,661</b>

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - prill 2009 (Jeta dhe Jo - Jeta)



## Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar - prill 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 62.05% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, në 4 - mujorin e parë 2009, arritën 927,102 mijë lekë, ose rreth 1% më shumë se në periudhën janar - prill 2008.

Në janar - prill 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 446,238 mijë lekë, ose rreth 42.08% më shumë se në periudhën janar - prill 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 4 - mujorit të parë të 2009 arritën në 62,319 mijë lekë, apo 28.05% më shumë se në periudhën janar - prill 2008.

## Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar - prill 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,223,002 mijë lekë, ose 58.10% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo - Jetës, me të ardhura 1,015,109 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 30.50%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 21.53%, sigurimi kasko me 21.08% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar - prill 2009 arritën në 134,633 mijë lekë, ose 81.03% më shumë se në periudhën janar - prill 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 75.93% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në 4 - mujorin e parë të vitit 2009 arritën në rreth 207,893 mijë lekë, ose rreth 32.45% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.


## Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo - Jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 29.29% të primeve.

Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar - prill 2009 (Jo - Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar - prill 2009 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 51.03% të primeve.

## Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - prill 2009 kapi vlerën 479,540 mijë lekë, ose 19.11% më shumë se në janar - prill të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 422,030 mijë lekë, apo 88.01% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një rritje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 19.55% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 51.22% krahasuar me periudhën janar - prill të vitit 2008.

## Risigurime

Gjatë periudhës janar - prill 2009, të ardhurat nga primet e veprimtarisë risiguroese kapën vlerën 11,403 mijë lekë, të cilat i përkasin portofolove të sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko” dhe janë prime të shkruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### Zhvillohet seminari mbi investimet dhe pagesat e sistemit të fondeve të pensioneve

Federata Ndërkombëtare e Administruesve të Fondeve të Pensioneve, FIAP dhe Dhoma e Pensioneve Polake, IGTE, zhvilluan gjatë periudhës 28 - 29 maj 2009, në Varshavë, Poloni, seminarin ndërkombëtar mbi investimet dhe pagesat e sistemit të fondeve të pensioneve.

Gjatë zhvillimit të seminarit, u promovua diskutimi i rregulloreve dhe praktikave më të mira për çështje të ndryshme, lidhur me fazat e grumbullimit dhe shpërndarjes së sistemeve të fondeve të pensioneve.

Në ditën e parë u bënë diskutime lidhur me vlerësimin e punës së fondit të investimeve të pensioneve, analizën e instrumenteve të reja financiare dhe strategjitë në portofolin e investimeve për fondet e pensioneve, ndikimin e krizës së tanishme financiare mbi sistemet financiare të pensioneve, kthimin nga fondet e pensioneve dhe rasti i Evropës Qendrore e Lindore, performancën financiare të fondeve të pensioneve të detyrueshme në Amerikën Latine, diversifikimin e portofolit ndërkombëtar për fondet e pensioneve, si dhe fondet e pensionit e investimet në infrastrukturë.

Në ditën e dytë, u analizuan çështje të ndryshme të lidhura me modelet e projektit të pensioneve dhe zhvillimin e tregjeve të efektshme për produktet e pensioneve. Së fundi, u shqyrtuan sistemet e pensioneve polake dhe evropiane në periudhën aktuale dhe në periudhën e ardhshme 2009 - 2019, reformat e pensionit në Poloni në kuadrin e reformave në botë dhe sfidat për të ardhmen.

Ky seminar përkoi me festimin e 10 - vjetorit të fondeve të pensioneve në Poloni dhe 13 - vjetorit të Kuvendit të FIAP. Seminari ishte i shtati në një seri të iniciuar që nga viti 2002.

Në të morën pjesë rreth 200 pjesëmarrës nga vende të ndryshme të botës (anëtarëve të FIAP dhe të tjerë), duke përfshirë edhe autoritetet qeveritare, anëtarët e parlamentit, zyrtarë nga agjencitë ndërkombëtare, përfaqësues të fondit të pensioneve, fondet reciproke, industrinë e sigurimeve dhe personalitetet e tjera që kanë të bëjnë me sferën e sigurimit social.

## Zhvillohet seminari mbi ruajtjen e të dhënave për bashkëpunimin me organet policore dhe gjyqësore në çështjet kriminale

Njësi i Ndërtimit të Institucioneve të Bashkimit Evropian (TAIEX) në bashkëpunim me Akademinë e Ligjit Evropian (ERA), zhvilluan në datat 7 dhe 8 maj 2008, në ambientet e Hotel "Tirana Internacional" seminarin mbi ruajtjen e të dhënave për bashkëpunimin me organet policore dhe gjyqësore në çështjet kriminale.

Qëllimi i seminarit, ishte zhvillimi i procesit të shkëmbimit të informacionit të autoriteteve, të cilat mbikëqyrin zbatimin e ligjit, për të arritur në këtë mënyrë një mbrojtje më efikase dhe mënjanimin e krimit të organizuar e terrorizmit. Ekspertët dhanë një përshkrim të detajuar të instrumenteve aktuale ligjore evropiane dhe ndërkombëtare që përdoren në fushën e mbrojtjes të të dhënave. Një vëmendje të veçantë ju kushtua kriterëve që duhen përmbushur për të arritur një shkëmbim efikas brenda Sistemit Schengen të Informacionit dhe gjithashtu për shkëmbimin e informacionit me agjencitë e BE-së për bashkëpunimin me organet policore dhe gjyqësore në çështjet kriminale, respektivisht: Europol dhe Eurojust.

Një rëndësi e madhe ju kushtua edhe iniciativave që janë ndërmarrë së fundmi brenda Bashkimit Evropian dhe jo vetëm, për të nxitur dhe zhvilluar procesin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve të ndryshme.

Në seminar, u paraqit kuadri ligjor aktual në Shqipëri, në lidhje me ruajtjen e të dhënave dhe një theks i rëndësishëm u vu në përshtatjen dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar në këtë fushë me direktivat evropiane dhe në rëndësinë që ka informimi i vazhdueshëm i subjekteve që merren

me ruajtjen e të dhënave, në lidhje me ndryshimet ligjore dhe praktike që ndodhin dita ditës në fushën e mbrojtjes e të dhënave për bashkëpunimin me organet policore dhe gjyqësore në çështjet kriminale.

## Zhvillohet seminari mbi menaxhimin në fushën e burimeve njerëzore

Gjatë periudhës 11 - 15 maj 2009, në Toronto, Kanada, Ministria e Bizneseve të Vogla dhe Shërbimeve Konsumatore, zhvilloi seminarin mbi menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në fokus të temave të trajtuara, ishin çështje të fushës së burimeve njerëzore, si:

- o Bashkëveprimi dhe pjesëmarrja.
- o Aktivitetet për ndërtimin (krijimin) e aftësive.
- o Instrumentet e aplikimit.
- o Instrumentet e burimeve.

Temat e trajtuara u ndanë në nëntemat e mëposhtme:

- Mundësitë për të mësuar nga njëri - tjetri, mënyrat e ndryshme të të mësuarit, si dhe mbajtja e vëmendjes në nivelin e duhur për të mësuar.
- Rritja e aftësive nëpërmjet praktikës.
- Sigurimi i mjeteve të duhura në mbështetje të punës.
- Ndarja e kompetencave në nxitjen e procesit të mëtejshëm të të mësuarit.
- Rëndësia e analizës së punës, aktivitetet dhe hapat për t'u ndërmarrë për këtë analizë.
- Menaxhimi i konflikteve në institucion (vendin e punës) nëpërmjet përcaktimit të fenomenit konflikt, të kuptuarit, mënyrat e identifikimit, si dhe zgjidhjen e tij.
- Selektimi dhe punësimi (procesi i rekrutimit) gabimet e zakonshme që bëhen në këtë proces, si

dhe shpërblimi i një rekrutimi e seleksionimi të saktë, i cili kryhet nëpërmjet analizës së aktivitetit të organizatës, analizës së punës dhe përshkrimit të vendit të punës. Një vështrim i hollësishëm u krye edhe mbi sistemin tërësor të punësimit nëpërmjet procesit përpara, gjatë dhe pas intervistës. Identifikimi dhe tërheqja e specialistëve të talentuar nëpërmjet lajmërimeve për vende pune dhe përshkrimit të detyrave specifike për secilin vend. Ky proces do të pasohet nga vlerësimi i formave, aplikimeve dhe rezumeve, tipeve të tyre, si dhe metodologjive që do përdoren për këtë qëllim. Intervista përmbledh metodiken për ta kryer atë, si dhe pyetjeve që do të drejtohen. Procesi i intervistimit kërkon aftësitë përkatëse nëpërmjet komunikimit dhe atyre efektive të dëgjimit.


Çështjet e diskutimit mbi menaxhimin e performancës, kishin të bënin me konceptin e performancës dhe përse ky koncept është kaq i rëndësishëm. Kjo performancë duhet të planifikohet nëpërmjet rishikimit të përshkrimit të punës, vendosjes së qëllimeve dhe pritshmërisë në drejtim të komunikimit institucional, si dhe identifikimit dhe eliminimit të pengesave gjatë këtij procesi.

## Zhvillohet trajnimi mbi zhvillimin e raporteve për projektin e sistemit të menaxhimit të informacionit (M.I.S)

*Firma zhvilluese Vizor, zhvilloi gjatë periudhës 25 – 29 maj 2009, në Dublin, Irlandë, trajnimin mbi zhvillimin e raporteve për projektin e sistemit të menaxhimit të informacionit (M.I.S).*

Vizor, është firmë zhvilluese, me aktivitet kryesor zhvillimin dhe rregullimin e sistemeve të

menaxhimit të informacionit. Klientët kryesorë të Vizor janë rregullatorët financiarë shtetërorë, ku përveç Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mund të përmendim Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Britanisë së Madhe (FSA), Autoritetin Qendror Financiar Ndërkombëtar të Dubait (DIFC), Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (ISA) dhe Bankën Qendrore të Irlandës (CBFSAI). Sistemi i menaxhimit të informacionit i Vizor është i profilizuar dhe i orientuar kundrejt funksionaliteteve të kërkuara dhe të përdorura nga institucionet rregullatore financiare, si dhe kundrejt procesit të raportimit periodik që këto institucione ndjekin ndaj subjekteve operuese në tregjet financiare që ato mbikëqyrin.



## **o Përshkrim i shkurtër i sistemit të menaxhimit të informacionit Vizor In-Reg.**

Sistemi i menaxhimit të informacionit Vizor In-Reg, përbën një prej projekteve madhore në proces të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky sistem konsiston në një portal periodik formash raportimi dhe menaxhimi të strukturuar të të dhënave financiare dhe të dhënave të tjera të kërkuara periodikisht për subjektet operuese në tregjet financiare, të cilat Autoriteti mbikëqyr, si dhe në një portal raportesh të krijuara në bazë periodike të informacioneve të mbledhura nga subjektet raportuese.

Automatizimi dhe informatizimi i proceseve të grumbullimit dhe ruajtjes së strukturuar të informacionit, bën të mundur shfrytëzimin dhe rialokimin e burimeve njerëzore, në detyra më tërheqëse dhe profesionale, si studimi i të dhënave dhe marrja e vendimeve të biznesit nga vlerat e të dhënave.

Të gjithë format e raportimit dhe raportet e publikuara në sistem janë të ndryshueshme dhe të konfigurueshme për të reflektuar çdo ndryshim në mënyrën, numrin, periodicitetin, apo sasinë dhe tipin e të dhënave të kërkuara. Teknologjikisht, sistemi i menaxhimit të informacionit është një aplikacion web, i ndërtuar në teknologji dinamike (ASP) dhe i mbështetur në një sistem (RDBMS), SQL Server 2005. Arkitektura e sistemit është projektuar në mënyrë të tillë që të mos ketë asnjë pikë të vetme dështimi, si dhe në çdo moment, rikthimi në funksionalitet i sistemit të realizohet në kohë minimale. Gjithë të dhënat financiare do transmetohen në mënyrë të sigurt dhe të paaksesueshme nga palë të treta të padëshirueshme, nëpërmjet internetit nga postet e punës të subjekteve financiare të mbikëqyrura drejt serverave qendrore të sistemit, i cili është i aksesueshëm nga çdo post pune, i pajisur minimalisht me një kompjuter personal me web browser (p.sh Internet Explorer) si dhe me akses në internet.

Format e raportimit si dhe raportet, zbatohen nga një aplikacion desktop i quajtur InReg

Builder dhe pasi i bëhen teste të ndryshme cilësisë, integrohen në sistemin qendror të menaxhimit të informacionit.

➤ Trajnimi filloi me një përshkrim të aftësive dhe të mjeteve të ofruara nga aplikacioni InReg Builder për ndërtimin e raporteve. Ndryshe nga ndërtimi i formave, ku kemi të bëjmë në pjesën më të madhe me ndërtimin e komponentëve për futjen e të dhënave, në procesin e ndërtimit të raporteve kemi të bëjmë me ndërtimin e komponentëve shfaqës të të dhënave. Në bazë të komponentëve shfaqës në nivelin e skemës logjike të raporteve, qëndrojnë llogaritjet e vlerave nëpërmjet lidhjes së tyre me vlerat e futura në forma dhe nëpërmjet funksioneve për tërheqjen e këtyre vlerave.

Pas një prezantimi teorik të mjeteve të ofruara nga InReg Builder, për ndërtimin e raporteve u kalua në disa shembuj të thjeshtë për ndërtimin e raporteve të thjeshta të bazuara në disa forma raportuese me një ose dy të dhëna.

Gjatë ditës së dytë, u trajtuan më thellësisht konceptet e raporteve të agreguara, duke qenë se përbëjnë pjesën më të madhe të raporteve aktuale që do të përdoren në sistemin e menaxhimit të informacionit. Gjithashtu, gjatë kësaj faze u trajtua dhe mundësia që të ofron InReg Builder për ndërtimin e shpejtë dhe nëpërmjet një wizardi, të raporteve të agreguara, të bazuara në një formë të vetme.

Më pas u trajtua pjesa e raporteve parametrike dhe ndërtimi i formës ku zgjidhen parametrat për një grup raportesh të caktuara. Një grup raportesh (p.sh grupi i raporteve të mbikëqyrjes) mund të ketë vetëm një formë për vendosjen e parametrave të raporteve. Pas mbarimit të disa ushtrimeve praktike mbi konceptet e përfituara në pjesën teorike të mësipërme, u kalua në fillimin e raporteve aktuale të sistemit të menaxhimit të informacionit. Fillimisht u krijuan strukturat dhe grupimet logjike për të gjithë grupet e raporteve të përcaktuara në templatet në Excel



dhe më pas u vazhdua me ndërtimin e raporteve aktuale të grupit të 'Raporteve të Mbikëqyrjes'.

Në ditët në vazhdimu trajtuan pjesa teorike e raporteve të bazuara në seritë kohore dhe e përdorimit të komponentëve grafikë në ndërtimin e raporteve si p.sh Pie Chart, Vertical/Horizonat Bar Charts apo Straight Line Charts. Pas trajtimit me ushtrime të raporteve të bazuara në seritë kohore dhe në komponentët grafikë u vazhdua me ndërtimin e raporteve konkrete të MIS. Gjithashtu u përfunduan gjashtë prej raporteve të mbikëqyrjes, konkretisht SR11, SR12, SR 15, SR16, SR19 dhe SR20.

Gjatë ditës së fundit u realizua një mbledhje, ku nga ana e Menaxherit të Projektit për Vizor, z. Matt Cusack, u paraqit skeduli i hapave të mëtejshme të konkludimit të ndërtimit të formave dhe të fillimit të ndërtimit të reportrve, si dhe të hapave të tjerë deri në daljen në prodhim të sistemit të menaxhimit të informacionit. Më pas, me prezencën e specialistëve të TI të Vizor, u zhvillua një seancë pyetje/pergjigje për disa çështje të rëndësishme administrative për vazhdimin e projektit.

## **o Koncepte të përgjithshme të sistemit**

### *Aplikacion web*

Aplikacion i aksesueshëm nëpërmjet një web browser, rrjedhimisht i programuar dhe i ndërtuar në një gjuhë programimi të mbështetur nga ana e teknologjisë web.

### *Aplikacion desktop*

Aplikacion, i cili për t'u ekzekutuar, ka nevojë për t'u instaluar në një kompjuter të caktuar dhe që ekzekutohet në ambientin e ofruar nga ai kompjuter, në ndryshim nga aplikacionet e web, të cilët ekzekutohen në një server web.

### *Sistem Menaxhimi Informacioni*

Ky sistem i referohet një sistemi të të dhënave e regjistrave dhe aktivitetet që procesi i të dhënave të informacionit, përfshin në një organizatë ku ajo

bën organizimin e manualit dhe proceset e automatizuar. Në një kuptim të ngushtë, termi Sistemi i informacionit (ose kompjuterin me bazë në sistemin e informacionit) i referohet të veçantave të aplikimit softwer, që përdoret për të ruajtur të dhënat e regjistrimeve në një sistem kompjuterik dhe automatës të disa prej aktivitetëve të përpunimit të informacionit të organizatës.

### *Vizor Inreg*

Aplikacioni web, zbaton Sistemin e Menaxhimit të Informacionit në të cilin do të raportojnë gjithë subjektet që operojnë në tregjet financiare që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kontrollon.

### *Inreg Builder*

Aplikacioni desktop, i cili bën të mundur zhvillimin e formave të raportimit dhe të raporteve, si dhe modifikimin e vazhdueshëm të tyre kundrejt specifikave dhe kërkesave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

### *Formë Raportimi*

Me termin formë raportimi do të quajmë çdo pasqyrë, tabelë apo lloj tjetër informacioni të strukturuar, i cili i vihet në dispozicion periodikisht Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nga subjektet financiare, të cilat operojnë në tregjet financiare ku AMF mbikëqyr. Format e Raportimit janë gjithmonë subjekt ndryshimi sipas kërkesave, specifikave dhe standardeve të raportimit të vendosura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë ushtrimit të funksionimit të tij si ent rregullator i tregjeve financiare jo-bankare.

### *Raport*

Në përgjithësi, me procesin e raportimit kuptojmë ekstraktimin e informacionit nga një ose disa burime të dhënash, prezantimin dhe afishimin e tij në një mënyrë kuptimplote dhe të lexueshme. Në analogji me këtë dhe raportet e gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, realizojnë pikërisht grumbullimin e informacionit nga format e raportimit, sipas kritereve të caktuara, të mirëcaktuara nga përdoruesit e biznesit, shfaqjen dhe prezantimin e tij në një format të caktuar.

## Zhvillohet forumi ndërkombëtar për sigurimet

Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve në USA (NAIC) me mbështetjen e IAIS, zhvilloi gjatë periudhës **18 - 19 maj 2009**, në Washington, USA, forumin ndërkombëtar për sigurimet.

Pas fjalës përshëndetëse të z. Roger A. Sevigny, president i NAIC, diskutimet kryesore u përqendruan në zhvillimet më të fundit të sektorit të sigurimeve, në kushtet e krizës globale që ka përfshirë botën për një mbikëqyrje sa më të mirë të tregut të sigurimeve dhe në përgjithësi të tregjeve të shërbimeve financiare. *Qëllimi i forumit ishte të rriste ndërgjegjësimin për çështje që preokupojnë tregun e sigurimeve për të gjithë komunitetin e rregullatorëve.* Ndër temat që u diskutuan, përmendim:

- o Kriza Financiare Globale dhe ndikimi i saj në tregun e sigurimeve dhe atë të rregullatorëve në sigurime.
- o Mbikëqyrja dhe rregullimi i aftësisë paguese dhe Menaxhimi i Riskut.
- o Konvergjenca e rregullatorëve në shkallë globale.
- o Qeverisja e Korporatave.
- o Promovimi i tregjeve të forta dhe të sigurta.

Në prezantimin e Sekretarit të Përgjithshëm të IAIS, **Z. Yoshihiro Kawai**, me temë: "Roli i IAIS në Menaxhimin e Krizës", ndër të tjera ai foli për krizën financiare, efektet e saj në tregun e sigurimeve dhe mbikëqyrjen e sigurimeve, rekomandimet e G20 dhe iniciativat ekzistuese të IAIS lidhur me to për realizimin e rekomandimeve.

*Iniciativat e ndërmarra nga IAIS:*

- o Integrimi i çështjeve që vinë nga kriza financiare dhe hartuesit e standardeve.
- o Kuadri rregullator për grupet ndërkombëtare të sigurimeve.

- o Ndryshimet rregulatore dhe plotësimi i boshllëqeve, aty ku ka.
- o Bashkëpunimi i mbikëqyrjes.
- o Vlerësimi dhe zbatimi i standardeve.
- o Risku kryesor dhe prirjet (tregu i risigurimeve globale).
- o Rishikim i drejtimeve strategjike.

*Rekomandime të G20-ës, të marra në konsideratë nga IAIS dhe të vlerësuara nga z. Kawai:*

- o Zhvillimi i një strukture ndërkombëtare të përbashkët dhe udhëzuesi për të ndihmuar autoritetet kombëtare të vlerësojnë, nëse institucioni financiar, tregu ose një instrument është sistematikisht i rëndësishëm në juridiksion.
- o Bashkëpunimi i mbikëqyrjes.
- o Menaxhimi i riskut, kontabiliteti, vlerësimi i shënimeve shpjeguese dhe shpërblimet.

*Çfarë parashikon IAIS për të ardhmen:*

- o Mbikëqyrja e grupeve aktive ndërkombëtare të sigurimeve.
- o Risku sistematik në sigurime.
- o Zhvillimi i mjeteve për mbrojtjen e makroçështjeve dhe sigurimi i autoriteteve lokale me opsione për zbatimin e tyre.
- o Monitorim i riskut të tregjeve të sigurimeve.
- o Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Gjatë zhvillimit të forumit, u nënvizua vazhdimisht nevoja e një kooperimi për një **Group Supervision**, që nënkupton mbikëqyrjen e tërë grupit nga një grup mbikëqyrësish, bazuar në ligjet lokale me një shkëmbim informacioni, ose dhe më tej, mbështetur nga njohje shumëpalëshe të ligjeve të juridiksioneve të grupit dhe një shpërndarje e qartë e përgjegjësisive midis mbikëqyrësve të përfshirë në grup. U theksua, rritja e kujdesit të hershëm dhe informacionit për riskun sistematik, i cili duhet të monitorohet përmes një mekanizmi të koordinuar global. IOSCO, IAIS dhe organizata të tjera të fushës duhet të sigurojnë asistencë teknike për përmirësimin dhe fuqizimin e kuadrit rregullator.

Në Forum, morën pjesë më shumë se 100 përfaqësues të rregullatorëve të sigurimeve nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, si dhe nga industria e sigurimeve në përgjithësi.

## Edukimi i konsumatorit

### Material për diskutim mbajtur nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (DP e BSNK) mbi sigurimet, perspektivë e forumit të CFO

(Pjesë e shkëputur nga: *The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice*, Vëllimi 33, nr.1, janar 2009)

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka publikuar një material për diskutim (DP) mbi kontabilizimin e kontratave të sigurimit dhe risigurimit. Ky projekt është bazuar në llogaritjen prospektive të detyrimeve të sigurimit, vlerën aktuale të daljes, që korrespondon me një vlerë transferimi me “vlerë tregu” (market consistent) të kontratave të sigurimit tek një pjesëmarrës tjetër në treg. Ky projekt është i ngjashëm me Parimet e Përpunuara (eng. Elaborated principles) të propozuara nga forumi i CFO në Qershor të 2006: një model i vetëm për llogaritjen e detyrimeve të sigurimit i bazuar në një përqasje me “tre shtylla”: flukset e parasë të pritshme në të ardhmen, të skontuara me normën pa risk, plus një marzh për riskun dhe pasiguritë.

Megjithatë, ka ndryshime të mëdha ndërmjet këtyre të dyve. Këto ndryshime i përkasin disa fushave: flukset e ardhshme të parasë (do të njihen vetëm flukset e parasë të cilat janë të ligjëruara ose të zbatueshme në mënyrë kontraktuale) metoda e “vlerës së tregut” (market consistent) (në veçanti vlerësimi i shpenzimeve duhet të bazohet në një nivel teorik të efektivitetit se sa në kostot e vetë siguruesve), marzhi i shërbimit (service margin) (sipas BSNK,

për t'u transferuar në një tjetër pjesëmarrës të tregut) dhe njohja e fitimit në fillim për marzhet fillestare (se sa njohje gjatë periudhës së kohës siç bëhet për shërbimet e tjera afatgjata). Siguruesit Evropianë nuk janë dakord lidhur me pikëpamjen e BSNK që ky koncept i marzhit të shërbimit është i përshtatshëm. Ata gjithashtu nuk janë dakord që tregu me pakicë dhe ai me shumicë për sigurimet janë të njëjtë. Ata mendojnë se ka një ndryshim domethënës ndërmjet çmimit të hyrjes dhe të daljes, që do të thotë një fitim fillestar domethënës. Siguruesit janë të shqetësuar për pasojat që mund të kenë këto propozime, të cilat do të çojnë në një vlerësim jo – ekonomik të detyrimeve në sigurime dhe në një model me mangësi të njohjes së fitimit. Meqenëse llogaritja e aktiveve dhe e detyrimeve në projektin Solvency II, duhet të bazohet tek IFRS-të, kontabilizimi i BSNK për projektin e sigurimeve mund të rrezikojnë Solvency II, e cila aktualisht bazohet në një metodë ekonomike të pasqyrës së bilancit. Forumi i CFO ka mbështetur llogaritjen me “vlerë tregu” (market consistent) të detyrimeve për qëllime kontabiliteti që është e njëjtë me çka është propozuar nga Solvency II. Forumi i CFO po konsideron alternativa për njohjen e fitimit gjatë kohës së kontratave kur risku çlirohet dhe shërbimet i kryhen policmbajtësve; këto alternativa duhet të jenë në përputhje me njohjen e marzhit të fitimit fillestar si kapital të disponueshëm për kërkesa të aftësisë paguese. *The Geneva Papers* (2008) 33,41 – 53. doi:10.1057/palgrave.gpp.2510163

### BSNK Faza II Projekt Kalendari

Në 3 Maj 2007, BSNK botoi për komente një DP mbi kontabilitetin e kontratave të sigurimit dhe risigurimit e titulluar *Këndvështrime Paraprake mbi Kontratat e Sigurimit* (“DP-ja”). Kjo është faza e dytë e projektit për kontratat e sigurimit, i cili në 2004 prezantoi një standard të përkohshëm (IFRS 4 – Standardi për Kontratat e Sigurimit) në mënyrë që të mundësojnë që kompanitë evropiane të sigurimit të listuara të pajtohen me kuadrin rregullativ Evropian dhe të hartojnë pasqyrat e

tyre financiare të konsoliduara sipas standardeve IFRS për periudhat financiare duke filluar nga 2005.<sup>2</sup>

Projekti i BSNK është shtyrë në kohë. DP-ja ishte planifikuar për në fund të 2006 dhe standardi final për në mes të 2009. Faktikisht, pas mbarimit të një periudhe 6 mujore komentesh më 16 Nëntor, 2007, hapi tjetër që do të ndërmerret, do të jetë ridiskutimi nga ana e Bordit në 2008. Më pas qarkullimi i draftit të IFRS faza II nuk do të ndodhë përpara 2009 (brenda 18 muajve nga publikimi i DP) dhe standardi final brenda një periudhe prej 12 muajsh të tjerë. Shtyrje të tjera në afate mund të ndodhin për shkak të punës për konvergjim ndërmjet BSNK dhe FASB<sup>3</sup>. Në 2 Gusht, 2007, FASB nxori një *Ftesë për Komente* e cila përfshin dhe DP e BSNK – së. FASB do marrë në konsideratë përgjigjet (të kërkuara që nga 16 Nëntori) për të vendosur nëse duhet të shtojë në axhendën e saj një projekt të përbashkët me BSNK për zhvillimin e një standardi gjithëpërfshirës për kontabilitetin e kontratave të sigurimit. Nëse FASB vendos të jetë pjesë e këtij projekti, atëherë janë të mundshme shtyrje të tjera në afate.

### **BSNK Faza II DP**

*Një përmbledhje e DP: elementët kryesore*

DP propozon një model të vetëm për kontabilitetin për sigurimin e jetës dhe për sigurimin e pronës dhe të aksidenteve të bazuar në një përlllogaritje në perspektivë të detyrimeve në sigurime. Në mungesë të një tregu, për detyrimet e sigurimit, përlllogaritja e detyrimeve në sigurime do të bazohet në tre shtylla kryesore:

- Flukset e projektuara të parasë në të ardhmen (vlerësime sipas një modeli të paanshëm statistikor “të ponderuar sipas probabilitetit”;
- Të skontuara me normën e interesit aktual të tregut, duke përfshirë të gjithë faktorët që influencojnë normën e vëzhguar por që s’janë të lidhur me detyrimet (p.sh risqet ekzistuese në instrumentin e përdorur si krahasues por jo të pranishëm në detyrime);
- Duke përfshirë një marzh të caktuar që

pjesëmarrësit në treg kërkojnë për të mbartur riskun (një “marzhi të riskut”) dhe për të siguruar shërbime të tjera, nëse ka ndonjë (një “marzh shërbimesh”).

Ky trajtim i përkufizuar si “vlera aktuale e daljes” (current exit value), korrespondon me një vlerë transferimi sipas vlerës së tregut (transferimi sipas kushteve të tregut tek një sigures tjetër i aktiveve dhe detyrimeve të lidhura me kontratat):

- Supozimet duhet të azhurnohen në çdo mbyllje.
- Vlerësimet, duke përfshirë kostot e trajtimit të kontratave dhe dëmeve, duhet të bazohen më tepër tek të dhënat e tregut ose portofolit se sa në të dhënat specifike të institucionit.
- Llogaritjet duhet të marrin në konsideratë çdo skenar të mundshëm: që do të kërkojë llogaritje sipas modeleve statistikore stokastike” (për t'u ekzekutuar në çdo mbyllje).
- Vlera aktuale e daljes (current exit value) do të lejojë njohjen e mundshme të fitimit në fillim. Megjithatë, fitimi në ditën 1 do të jetë i limituar në shumën aktuale të marzhit të fitimit në primin si tejkallim i riskut dhe marzheve të shërbimeve (nëse ka), i cili do të ngarkohet nga pjesëmarrës aktivë të tregut në një transferim teorik (praktikisht Bordi në shumicën e rasteve nuk pret fitim domethënës në fillim).

Bordi ka refuzuar “vlerën aktuale të hyrjes” (current entry value), që është, të barazpeshojë marzhet me primet edhe nëse kjo metodë mund të çojë në disa referenca të dukshme. DP merr në konsideratë disa çështje specifike: Prime të ardhshëm, sjellja e policmbajtësve, garantimi i sigureshmërisë dhe shpenzimet e marrjes në sigurim:

- Vetëm primet e lidhura me kontratat ekzistuese duhet të njihen.
- Primet që varen nga sjellja e policmbajtësit dhe që nuk janë nën kontrollin e siguresit nuk do të njihen. Megjithatë, njohja do të përfshijë primet e ardhshme që policmbajtësit duhet të paguajnë që të fitojnë të drejtën për të siguruar mbulim të

vazhdueshëm pa pasur nevojë për konfirmimin e profileve të riskut të tyre, me një çmim që është i detyrueshëm në mënyrë kontraktuale.

- E drejta e siguresit që i korrespondon kësaj marrëdhënie me klientin është kaq shumë e lidhur me kontratat sa që ajo duhet të njihet jo si një aktiv por si e zbritshme nga detyrimet në sigurime.

- Shpenzimet e marrjes në sigurim duhet të konsiderohen si shpenzime.

### **Kontratat me pjesëmarrje**

- Të drejtat e pritshme për pjesëmarrje të policmbajtësve nuk duhet të njihen si një detyrim (por si fitime të mbajtura) deri në momentin që siguresi të ketë një detyrim të pakushtëzuar dhe konstruktiv për të transferuar përfitimet ekonomike tek policmbajtësit, aktual ose të ardhshëm.

- Vetëm nëse një detyrim i tillë bëhet real më pas duhet që siguresi të njohë detyrimin që rezulton si dhe të njohë një shpenzim në atë moment.

### **Njësia e llogaritjes, marzhi i riskut dhe diversifikimi**

- Llogaritjet e flukseve të ardhshme të parasë të ponderuara me probabilitetin do të bëhen në baza kontratë pas kontrate. Bazuar në evidenca statistikore, rezultati do të jetë i njëjtë si në nivel agregat portofoli.

- Megjithatë, marzhet e riskut janë të ndikuar nga madhësia e njësisë llogaritëse, e cila është, portofoli i kontratave subjekt i risqeve të ngjashme dhe të menaxhuara bashkë.

- Kjo metodë lejon për efektin e grumbullimit të risqeve në portofole por jo për efektet e diversifikimit ose korelacionit negativ të risqeve ndërmjet portofoleve (karakteristika që janë specifike për një entitet se sa për një portofol).

*Ndarja e komponentëve financiarë dhe të sigurimeve*

Standardi i Fazës II duhet të aplikohet në të gjithë kontratën, nëqoftëse komponentët janë kaq të ndërvarur sa që ato mund të maten vetëm të ndara mbi baza arbitrare.

Në raste të tjera:

- Nëqoftëse komponentët nuk ndërvaren, IAS 39 duhet të aplikohet tek elementi depozitë dhe standardi i Fazës II duhet të aplikohet tek elementi sigurim.

- Nëqoftëse komponentët janë të ndërvarur por mund të llogariten në mënyrë të veçantë mbi baza që nuk janë arbitrare, IAS 39 do të aplikohet tek elementi depozitë. E gjithë kontrata do të vazhdojë të merret në konsideratë sipas parimeve të standardit të Fazës II me elementin sigurim i llogaritur si diferenca ndërmjet shumës për të gjithë kontratën dhe elementit depozitë. Shkaku themelor është ekzistenca e të ashtuquajturës “depozitë dysheme” sipas IAS 39 (vlëra e drejtë e çdo instrumenti financiar nuk mund të jetë më e ulët se sa vlëra e kërkesës siç është për depozitat bankare, pavarësisht sjelljes së klientëve). DP – ja nuk kërkon këtë “depozitë dysheme” për kontratat e sigurimit por lejon për të marrë në konsideratë flukset e pritura të parasë të ponderuara me probabilitetin. BSNK – ja do të parandalojë siguresit të kryejnë arbitrazh në kontabilitet ndërmjet IAS 39 dhe standardit të Fazës II.

### **Referenca:**

DP – Discussion Paper (Material për diskutim)

IASB – International Accounting Standards Board –  
BSNK – Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

### ***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, T. Cani, I. Jorgo,  
E. Sherri, P. Berberi, Dh. Hazbiu, R. Eltari,  
E. Zalta, E. Kokona

